NË QYTETIN TIM
Në qytetin tim
Paska edhe gra të bukura
Këtu mermeri i skalitur
shkrihet
Në lotin e brishtë të
Lumëbardhit
Kurse nën Urën e Gurit në
heshtje
Si përherë rrëshqasin shekujt

Po të lexohen me vëmendje poezitë e Zaplluzhes, vëren se brenda tyre gërshetohen element material, substancial, shpirtëror, mendor, kreativ, social e shoqëror, përmes të cilëve mishërohet realiteti aktual me ndjenjat dhe përjetimet emocionale të autorit, dhe i gjithë ky kompleks, kjo shumanshmëri ka një dominant rreth së cilës përmblidhen gjithë përbërësit e saj që dallojnë nga poezitë e tjera - ka botën e thellë imagjinare dhe shumëdimensionale të Zaplluzhës, pra botën e nënndërgjegjshme, që kalon edhe përtej kufijve të së dukshmes...

Sabir Krasniqi
Kreuzlingen, 01.10.2014

Adem Zaplluzha - NË PREHRIN E PEMËVE

Adem Zaplluzha

NË PREHRIN E PEMËVE

POEZI

ADEM ZAPLLUZHA

NË PREHRIN E PEMËVE

Poezi

Redaktor:
Sabir Krasniqi

Recensent:
Mazllum Baraliu

Lektor:
Veli Veliu

Ballina:
Sabir Krasniqi

ADEM ZAPLLUZHA

NË PREHRIN E PEMËVE

Poezi

"TREND"
2015

Ky libër i kushtohet profesorit të ndritur, kolosit dritëdhënës, personalitetit gjenial, enciklopedisë së gjallë, filozofit të madh, Sokratit shqiptar, **Qazim Berisha**, i cili kultivoi në mendje e shirit, gjatë gjithë jetës, dashurinë më sublime për rrezet më shkëlqyese të jetës - **dijen hyjnore**!

E çmonte thjeshtësinë, ashtu sikurse edhe Sokrati... e mbronte të vërtetën siç e mbrojti edhe Ai, sepse e vërteta ishte vet jeta e tij! I gatshëm të pranoj edhe vdekjen por jo të jetoj nën barrën e hijeve të shëmtuara të jetës. Peshonte vlerat njerëzore, jo me barometrin e titujve, pozitave, pasurisë, pushtetit, por me vlerat më të pastra morale e njerëzore... me fisnikërinë shpirtërore! Një herë kur e pyetëm profesorin, pse nuk i kishte pranuar pozitat e larta të ofruara nga pushteti, ai u përgjigj shumë popullorçe: "**kisha frikë se mos po marrë mësysh!"** Po cila mendje e ndritur pranon ta ndrydhë të vërtetën për hir të hipokrizisë? Cila mendje e ndritur pranon vasalitetin për hir të pozitës?! I tillë ishte profesor Qazimi - i varfër materialisht, por i pasur në mendje, në shpirt e në zemër, dhe këtë pasuri, këtë thesar të çmuar, këtë dije kolosale, këto

urtësi universale, këto rreze të ARTA... i shpërndau për më se 40 vite në vazhdimësi...

Edhe pse i goditur rënd nga sfidat e jetës, profesor Qazimi, nuk u thye asnjëherë, përkundrazi, ai i përballoi ato... duke u ushqyer me frymën e së vërtetës, duke ndjekur zërin e ndërgjegjes, duke kultivuar farën e mirësisë, farën e dashurisë njerëzore... derisa u nda fizikisht nga ne, më 6 prill të vitit 1999, atëherë kur flakët e predhave, nga fluturaket e NATO-s, po e dënonin dhunën dhe terrorin e tmerrshëm serb, por edhe po ndiznin shkëndija shprese se liria, më në fund, po agon edhe për këtë popull të shumëvuajtur - lirinë, që profesor Qazimi nuk arriti ta përjetoj fizikisht, por që e kishte ndjerë gjatë gjithë jetës së tij...

Profesor Qazimi do ta ketë përgjithmonë vendin meritor në plejadën më të ndritur të pishtarëve të arsimit dhe të edukatës

Sabir Krasniqi

Parathënie

GJURMË NË KOHË!

"Nevoja e artit nuk është të prezantojë se si duken gjërat në aparence, por se çfarë kuptimi mbartin ato në brendësi"

Aristoteli

Nga kopshti i mrekullueshëm, tejet kreativ, i poetit Adem Zaplluzha, nga ky burim i pashtershëm krijues, sërish rrodhën vargje përplot koloritet që di t'i gërshetoj aq bukur, me fijet më të ndjeshme estetike, vetëm një shpirt i madh artisti dhe përmes tyre të krijoj valorizim të përsosur ritmor mes zërit të arsyes dhe magjisë së ndjenjave... Po nuk thuhet kot se: "Poetët janë si retë mbi det - thithin ujin e njelmët, për të lëshuar shiun ëmbël".

Te jesh poet nuk është edhe aq e lehtë pasi duhet t'i shohësh dukuritë përreth, dhe botën përgjithësisht, nga disa dimensione! Duhet të veshësh me petkun e atyre dukurive dhe t'i përjetosh edhe vet! Të përballesh me të mirën e të keqen, me gëzimet e hidhërimet, me lumturinë e pikëllimin, me qetësinë dhe shqetësimet, me dhimbjet, brengat... për të nxjerr nga gjithë këto

ndjesi edhe kuptimin filozofik, estetik, psikologjik, retorik, metaforik, porosinë dhe përmbajtjen, përmes zërit tënd të brendshëm, përmes syve të shpirtit; të dish të lundrosh në hapësirën e valëve krijuese, të dish të kapësh ritmin e melodisë së caktuar, të gërmosh në themelet e brendshëm për t'i dhënë dimension universal vargut artistik. Dhe mu këtë ka arritur ta bëj poeti i madh Adem Zaplluzha edhe në këtë libër të radhës, të 119-të, të titulluar, "Në prehrin e pemëve". Kur them poet i madh e them me plotë bindje, pa frikë se mund të bie në subjektivizëm të tepruar, pasi madhështor autorin e bën puna e tij, veprat e tij, jo vetëm nga sasia, fondi i pasur krijues (118-të të botuara deri më sot), por nga përmbajtja dhe vlerat artistike që bartin dhe pasqyrojnë ato, të krijuara në një vazhdimësi më shumë se gjysmëshekullore. Nuk mund të mos e cek në këtë rast edhe thënien e I. Njutnit: „Në rast se unë kam parë më larg se të tjerët, kjo ka ardhur sepse kam qëndruar mbi supet e gjigantëve“, e sup gjigant, poeti Zaplluzha, ka pasur një kokë gjeniale, enciklopedinë e gjallë, filozofin e madh, Sokratin shqiptar, profesorin e ndritur Qazim Berisha.

Poezia, gjegjësisht vepra artistike, është një fryt i një bashkëpunimi të ngushtë mes objektit - veprës që duhet krijuar, dhe subjektit krijues - pra vet artistit, që në fakt, është si një lloj “autoportreti” i ndërgjegjes estetike të krijuesit. Akti thelbësor i këtij bashkëveprimi është përjetimi

personal i dukurive përmes shqisave dhe ndjenjave; perceptimi i fuqishëm emocional i gjithë larmisë së botës shqisore me tingujt, aromat, ngjyrat, lëvizjet, format e saj dhe zbërthimi e riprodhimi estetik i këtyre refleksioneve, dukurive të jashtme fizike të realitetit që na rrethon, përmes botës imagjinare, duke i derdhur e fiksuar ato përmes vargjeve ose figurave artistike.

Si një "autoportret" i ndërgjegjes estetike, çdo poezi, ose vepër tjetër artistike, në fakt, përmban edhe një pjesë të jetës së krijuesit, një pjesë të shpirtit të tij. Edhe në poezitë e Zaplluzhës frymojnë ndjenjat, mendimet e përjetimet, që autori i ka të freskëta nga të gjitha periudhat e jetës dhe të cilave u jep jetë, i materializon artistikisht, i zbukuron estetikisht, përmes vargjeve të derdhur mbi letër.

Gjatë rrugëtimit jetësor, vërejmë përmes poezive të tij, se autori e ka ndjek, e ka ndjerë dhe përjetuar peshën e kohës, peshën e zhvillimeve historike, politike, kulturore e shoqërore të atdheut, që janë treguar shumë të pamëshirshme, shumë të padrejta dhe shumë të egra, pothuajse, në të gjitha sferat e jetës, dhe kjo ka bërë që, në përpëlitje me shpirtit e tij krijues, autori të reflektoj këtë gjendje të brendshme në poezitë e tija dhe të na jep përshtypjen e një poeti të mjerimit dhe dëshpërimit që, në fakt, nuk qëndron pasi marshimi i shpirtit të tij luftarak, por edhe rebelues ndaj dukurive

përreth, nuk është mposhtur para asnjë sfide të kohës! Në vargjet e tij spikat edhe historia: burrëria, besa, guximi, trimëria, mençuria etj., si në poezitë: "Po e hidhëron tokën", "Gjyshi im luftëtar i disa luftërave", apo në poezitë: "Nëse ngjan e kundërta", "Herë i përngjajmë njeriut", ku autori futet në brendi të shpirtit dhe, nga aty, reflekton realitetin e brendshëm psikologjik përmes variacioneve alegorike; ose vargjet kushtuar tragjedisë gjithëkombëtare - eksodit masiv të shqiptarëve të Kosovës në periudhën mars-qershor 1999, në poezitë: "Herë binte shi i mrrolur", "Një hije vdekjeprurëse", që kanë lënë gjurmë, jo vetëm tek poeti, por në histori. Poeti nuk i kursen as dukuritë e shëmtuara shoqërore - ato të shkatërrimit mjedisorë, si në poezinë "Lumin që e njoha njëherë moti", ku atë e brenë dëmtimi i natyrës, por nuk e lënë të qetë as veprimet ekstreme fetare dhe ai ngre zërin në mbrojte të vlerave elementare të lirisë njerëzore - pra vet jetës, në poezinë, "Nuk kam kohë për të humbur", po e anashkaluar për asnjë çastet as botën fëmijërore, për të cilët ai shpreh dashuri të veçantë e që, edhe në realitet, kjo botë fëmijërore është pasqyrë më shkëlqim të veçantë i ndjenjave dhe vlerave më madhështore e më të pastra njerëzore, sa që poeti i quan të vegjlit kardinal, në poezinë, "Të vegjlit janë kardinal". Në vargjet e poetit është e pranishme përherë edhe nostalgjia për vendlindje, për qytetin historik e piktoresk të Prizrenit, për Urën e Gurit, për

Lumëbardhin që gjarpëron nën të e që, ai, e bartë me vete kudo, edhe në poezinë "Në qytetin tim", por poeti nuk e harron asnjëherë as elementin thelbësor të qenies njeri, emocionin më dinamik, ndjenjën e thellë, energjinë e fuqishme dhe të pafund që depërton deri në poret më të imta të qenies sonë, duke na rrëmbyer trupin e shpirtin - nektarin e ëmbël të dashurisë, dhe këtë gjuhë të zemrës ai e shpalos përmes poezive: "T'i preki yjet kah çelin zogj", "Shikimet e tua të largëta".

Po të lexohen me vëmendje poezitë e Zaplluzhës, vëren se brenda tyre gërshetohen element material, substancial, shpirtëror, mendor, kreativ, social e shoqëror, përmes të cilëve mishërohet realiteti aktual me ndjenjat dhe përjetimet emocionale të autorit, dhe i gjithë ky kompleks, kjo shumanshmëri ka një dominant rreth së cilës përmblidhen gjithë përbërësit e saj që dallojnë nga poezitë e tjera - ka botën e thellë imagjinare dhe shumëdimensionale të Zaplluzhës, pra botën e nënndërgjegjshme, që kalon edhe përtej kufijve të së dukshmes, logjikës racionale, për tu stacionuar në pafundësinë e parajsës shpirtërore, aty ku ndjenjat, të lira prej logjikës së kodifikuara, arsyes së kornizave të sipërfaqësores të kufizuar nga perceptimet shqisore ndaj botës objektive, shprehen me gjuhën e pastër engjëllore, aty ku gjendesh përball pasqyrës që reflekton realitetin tënd - dhe t'i sheh, me sytë e shpirtit, përtej kornizave të së dukshmes. Në këtë oazë kristalore,

shpirti flet me gjuhën e ndjesive më të çiltra e më të pastra, gjuhë me të cilën në botën e arsyes vështirë mund t'i kapësh përgjigjet... Këtu gjithçka është hyjnore, sepse rrjedh natyrshëm, ashtu siç është dëshira dhe vullneti i vet shpirtit njerëzor - këtij shpirti që i dha bekim dhe frymë vetë Madhështia, prandaj poezitë e Zaplluzhës i shpërfillin rregullat e kornizave të sipërfaqësores nëpër të cilat është mësuar të lëviz mendja jonë me sjellje, norma të kufizuara e të kodifikuara, çofshin ato edhe drejtshkrimore. Nocioni se gjithçka mund të jetë "racionalisht" e shpjegueshme është veçori e "epokës moderne", një epoke të kufizuar vetëm në logjikë dhe arsye! Është absurde t'u kërkosh poetëve t'i shpjegojnë ndjenjat e tyre, botën imagjinare! Ndjenjat nuk shpjegohen - ato vetëm ndjehen, përjetohen.

Dhe mu ky stil i të shkruarit, pa kodifikime, i lirë në nënndërgjegjen tonë, që edhe është burim i pashterur i motivimit dhe kreativitetit krijues, e bën edhe më të afërt lexuesin me poezitë e autorit Zaplluzha, e bën lexuesin pjesë të poezisë, duke mos e lëne pasiv të kaloj mbi rreshta formalisht, por duke u thelluar në brendi të tyre dhe mishëruar me ta. Lexuesit i duhet të depërtoj përmes vargjeve të pasura me metafora, të endet si një bletë lule më lule, që në fund ta shijoj nektarin e ëmbël të vargut të shkruar, që në të shumtën e rasteve fletë më shumë se një shkrim i tërë proze.

Poeti Zaplluzha, çështjen e shtruar të vargut nuk e shpreh për të krijuar formalisht, por ai ka rimtin e caktuar të rrjedhës, simbolikën e thellë, magjinë e fjalës, fjalorin e tij të pasur, madhështinë e metaforës, metrikën e kohës, intonacionin që di të jetë edhe i ashpër po edhe i butë, ka figurat, koloritetin dhe shkathtësinë për t'iu dhënë kuptim e jetë vargjeve të tij.

Edhe në këtë përmbledhje të tij poetike, por edhe në ato të hershme, poeti Zaplluzha, përpiqet që lexuesit t'i jap diçka më shumë e më përtej mendimit të rëndomtë, ai kalon përtej caqeve të të kuptuarit logjik për ta pasqyruar realitetin e transformuar, që në gjuhën e estetikës quhet art.

Veprën me poezi, "Në prehrin e pemëve", autori e ndanë në tri cikle: cikli i parë - "Kur shiu i zgjatë duart", cikli i dytë - "Mbetëm si tingujt e metaforës" dhe cikli i tretë - "Shoh se si përpëliten eshtrat", brenda të cilëve janë të përmbledhura 69 poezi.

Qëllimisht nuk kam bartur vargje nga poezitë, siç ndodhë zakonisht në parathënie librash, për të komentuar përmbajtjen dhe mesazhet e tyre në mënyrë më të hollësishme, se do më duhej vërtet shumë kohë, pasi në secilin rresht, të poetit të madh Zaplluzha, është e shkrirë një histori! Këtë po ua lë lexuesve të nderuar dhe të etur për fjalën e shkruar që ta lexojnë, shijojnë, përjetojnë dhe

interpretojnë secili në mënyrën e vet, pasi secila qenie është një unikat në vete.

Thuhet se jeta është një rrugëtim! Rrugëtim nga një skaj, në tjetrin! Proces i natyrshëm i ligjit universal... Shumëkush këtë rrugëtim e mat me hapa! Shumë të tjerë e peshojnë me kohë - sekonda, orë, ditë, vite të llogaritura në kalendarë... por edhe të tillë që e kalojnë të zhytur në melankoli! Adem Zaplluzha këtë rrugëtim jete është duke e matur e peshuar me GJURMË - gjurmë të trasuara me bardhësinë e shpirtit dhe ngrohtësinë e zemrës, gjurmë të trasuara me fuqinë e mendjes dhe mprehtësinë e penës, gjurmë të trasuara me vlerat më të larta, më të pastra e më të çmuara: artistike, intelektuale, shoqërore e njerëzore - gjurmë që mbesin në kohë përjetësisht.

"Arti është krijuar që të përjetohet e jo të kuptohet. Andaj, çdo herë artet, kur dëshirojnë të jenë të kuptueshëm, çdoherë thonë budallallëqe"

Drajzeri
Sabir Krasniqi
Kreuzlingen, 01.10.2014

Kur shiu i zgjatë duart
Cikli i parë

HËNA E MEKUR

Mëngjesi i trishtë
Kurse unë kam frikë nga errësira
Një diell i mrroltë
Si statuja e ngrira të atdheut tim
Më mbështeten mbi rrashtën drobitur

Pamjet surrealiste të barit të verdhë
Duken tepër frikësuese
Hëna e re shikon nga lartësitë
Se si shkrihet
Ngjyra e portokalltë e diellit

Një copë e madhe prej mjegulle
Vrapon shëtitoreve
Pas qeshjes së perëndeshës së gurtë
Mermeri i kuq
Përjeton vdekjen e gladiatorëve

Shiu i ngrohtë i dimrit
Sërish pikon mbi trëndafilat
Kah çelin dhembje
Hëna e mekur nga udhëtimet e gjata
I këput lulet e fishkura të Lumëbardhit

OSE I LUTEJ ERËS SË VERBËT

Mbi çatitë e mykura
Qëndronte mendueshëm portreti i erës
Ajo sërish i përtypte mjegullat e brymta
Nga gjuha e ullukëve si trishtimi
Pikonte rrëshira e verdhë

Kudo nëpër lagje vraponte sterra
Era i kishte hapur krahët
Dhe i përqafonte lulet kah çelnin
Nga një copë të dhembjes së verdhë
E shiu rigonte si i çmendur
Në përparësen e mbrëmjes

Kudo trishtim nëpër rrugët e zhveshura
Këpucët e kaltra të stinës
I arnonte mëngjesi
Dielli surrealist mbi pullazin e kujtesës
Shikonte tërë pikëllim
Se si këputeshin degët e mjegullave

Sërish një hënë e re qante nën ullinj
Nga trungjet e thyera
Si loti i trishtë çurgonte vaji
Bari rrinte ulur në gjunjë
Ose i lutej erës së verbët
Të tregonte se si luteshin njerëzit

NUK DI SE KU JAM SOT

Një tingull i zbrazët
Derdhej nga buzët e njoma të gjetheve
Pranvera si kali i harlisur
Vraponte kah e nesërmja
Nëpër rrugicat e ngushta të kujtesës
Dëneste malli i atdheut

Nuk di se ku jam sot
I kujt është ky qytet që më shikon
Me sytë e huaja të stinës
Shiu nuk di të pushoj kurrsesi
Mbi çatinë e dhembjeve
Shpalosen kujtimet

Ky përmallim i shurdhtë
Frikshëm më shikon
Me sytë e huaj të dimrit
Lejlekët paskan ikur shumë herët sonte
Me tërë frikë dridhet bari i verdhë

Çfarë të bëjë me duart e mia
Që po ma ngacmojnë trupin e ngrirë
Një shi idhnak
Derdhet nga shtambat e thyera
Kush i shqeu sonte këto mjegulla të arnuara

KUR SHIU I ZGJATË DUART

Asnjë zog i verbër nate
Nuk paska mbetur në këtë rrah
Kanë ikur kanjushat e verdha
Kush këndoi mbrëmë
Mbi degët e këputur të vetmisë

Hëna ishte ulur në shtrojerë
Dhe dëneste se jetime
Sytë e verdha të trëndafilit
Kishin marrë një ngjyrë tjetër
Ngjyrë të murrmë trishtimi

Te portat e jashtme s'dëgjohen zërat
Askush më nuk troket
Në dhomën time të fjetjes hijet lozin
Një valle të lashtë pagane
Lozin për nder të perëndive të vdekur

Në gjumin e rrapeve të moçëm
Këndojnë zgërbonjat
Era e fortë hyn nëpër dhomat e trishtimit

Kurse shiu i zgjatë duart
Te portat e jashtme
Dëgjohen trokitjet e çmendura

LUKUNITË E ZEZA TË UJQËRVE

Si nga parzma e nëntokës
Më vijnë zërat e lashtësisë
Vijnë edhe hingëllimat e kalorësve
Të apokalipsit
Katër kuaj të zinj i përngjajnë etjes
Sytë e verdhë trishtimit të urisë

Një hije e thyer në qindra copëza
Rrokulliset tërmal luadhit
Kurse lumi i çmendur hungëron
Si një bishë e plagosur
Në peharin e skamjes
Vdesin zogjtë e fundit të stinës

Një lule e verdhë
Posa çeli trishtim mbi një gur
Në shpirtin e kafshatës së mykur
Veç kanë filluar të vdesin shpresat
Nëpër qiellin e brymtë të atdheut
Hungërojnë
Tmerrësisht hungërojnë
Lukunitë e zeza të ujqërve

DIELLI I URITUR I PËRTYP HIJET

Në fundin e zbrazëtisë
Së boshatisur
Përpëlitet etja
Dielli i uritur i përtyp hijet
Lagja dënes si një kalama i dehidruar

Dënesin edhe kavakët
Selvitë i kanë lëshuar degët
Deri në tokë
Në sofrën e skamjes
Pikëllimi drekon urinë e përditshmërisë

Një zog i verdhë mbanë në sqep
Detin e trishtuar të kafshatës
Sytë janë tretur në zgavrat e kafkës
Askund asnjë pikë uji
Për larjen e plagëve

Këtu më nuk dihet
Kur është mëngjesi
Ose kur përfundon mbrëmja
Kapakët e syve mbyllen në heshtje
Mbyllen si dritaret e shtëpive të braktisura

Prishtinë, 4 gusht 2014

NJË NGA NJË PO BIEN PERËNDITË

Një pasqyre e përhitur
Vajton rrezet e para të diellit
Andej bregut të dhimbjes
Lumi i etur bisedon me rërën
Bari i venitur paska mbetur jashtë lojës

Këtu era frynë vetëm njëherë në ditë
Kurse herëve të tjera
Llamburit lumi i ngrirë i kujtesës
Sytë e lëmekur të dritës
Shikojnë Ballkanin e trazuar

Një zjarr i paparë fërshëllen ndër lisa
Gjethet lozin tangon e fundit
Kjo vjeshtë e vonë
I paska mbathur mbrapshtë
Sandalet e kuqe të mëngjesit

Një shi i imtë përzier me shtrezë
Pandërprerë po bie
Po bie mbi gjethet e stinës
Si perënditë pagan po bien edhe ëndrrat
Një nga një po vdesin perënditë

ASNJË ZOG NUK FLUTUROI MBRËMË

Ajo i mbante ndër sqetull
Shamit e përshëndetjeve të erës
Një nostalgji e lashtë
Zgjohet në kreshtat e këndesit plak

Asnjë zog mali
Nuk paska mbetur këtu në rrah
Kah fluturuan kanjushat e verdha
Një udhëtar i vetmuar vdes nga ngashërimet

Syri i përlotur i erës
I pastron sklepat e natës në heshtje
Një dorë e rrudhosur i përkund kujtimet
Kush po dënes nën atë çati të boshatisur

Një grua e moshuar përkund djepin e zbrazët
I përkund edhe trishtimet e jetës
Mbi çatinë e harruar të lagjes
Asnjë zog nuk fluturoi mbrëmë

PO BIE NJË SHI I PËRGJUMUR

Gjëra të çuditshme po ndodhin
Brenda meje
Dhe eklipsit të diellit
Një hënë me shpirtin e saj nudo
Këndon një serenatë

Yjet paskan zënë e po çelin
Disa lloje lulesh të panjohura për ne
Një mjegull i murrmë
U bënë hije gjetheve
Që përgatiten të vdesin si mbretërit eunuk

Jashtë dhomës së errët
Po bie një shi i përgjumur
Te portat e verdha të qytetit
Kanë dalë vashat
Dhe po presin kthimin e luftëtarëve

Një zog i trishtuar i lëshoi vezët
Mbi degët e akacies së vjetër
Dy çupa të bukura thurin gjerdanin e erës
Në gjumin e rrapit të vjetër
Pandërprerë po troket shiu idhnak

NËN MUSTAQET E BRIGJEVE TË VIRGJËR

Mbi një copë toke prej deltine
Të shkriftë
Fle një yll i kaltër
Deti i zbardhur flokësh
Duket si një relief që s'mund të lexohet

Nën mustaqet e brigjeve të virgjër
Peshqit notojnë në grupe
Mes oqeanit të vetmuar
Për një përralle të lashtë
Meduza këndon një këngë të vjetër

Sytë e erës lotojnë kristale fjalësh
Mbi muret e rrënuara të kujtesës
Çelin detet disa lloje speciesh të rralla
Bunaca i shkulë nga mendja
Dallgët e kripura të erës

Te fanari peshqit në grevë urie
Këndojnë një psalm të vjetër
Era i solli sandalet e një tregimi
Që zuri fill
Për herë të parë në trevën tonë

LEHNIN EDHE ZOGJTË NGA URIA

Sërish po kthehem te ty qyteti im
Po kthehem te baladat
Që lindën kur ne nuk kishim
Se me çka t'i mbushnim rropullitë

Dashuria na dukej diçka e huaj
Diçka që na kafshonte si hija e zezë
Ishin kohërat e liga
Kur ulërimat dëgjoheshin skutave

Në çdo kthesë të lagjes
Lehnin edhe zogjtë nga uria
Lehte qielli pas stërkalave të dyshimta
Që binin mbi çatitë e thyera të fshatit

Si një saç i përskuqur
Dielli dukej në hapësirë
Mbi kokat tona
Si llava reshnin mjegullat

Nëpër degët lakuriqe
Aty këtu
Dukeshin zogjtë e pjekur
Shiu kishte ikur pas shtatë bjeshkëve

NUK KAM KOHË PËR TË HUMBUR

Sonte nuk kam nevojë
Për të humbur
Mes vargjeve të mia
Dua të fundosem në shpirtin e gurit
Dhe t'i dëgjoj zërat e arsyes

Nuk kam kohë për të humbur
Mes këtyre thashethemeve
Aq shumë u besoj zogjve
Sa që një ditë
Do të mësoj edhe fluturimin e tyre

Ikën edhe ata të fundit
Që nuk besonin
Se njeriu si një qenie e përkryer
Nuk i beson askujt
As atyre që vrasin në emër të fesë

Unë u besoj atyre
Që kurrë nuk i besuan askujt
Vetëm ata nuk vrasin njerëz
Në emër të besimit
Dhe fesë
Kjo nuk ka ngjarë deri më sot
Që në emër të mosbesimit të vritet njeriu

HERË BINTE SHI I MRROLUR

Nëpër platforma anijesh
E autobusësh të vjetër udhëtonin njerëzit
Largoheshin nga atdheu
Miqtë e mi të varfër
Ishin pamjet groteske të ikjeve

Iknin edhe minjtë e gjirizeve
largimet ishin të përditshme
Njerëzit iknin nga çdo gjë
Që mund të ikej
Iknin edhe pasqyrat e dyshimta të mjegullave

Herë binte shi i mrrolur
E herë shtreza e murrme qante
Nëpër ullukët e fshatit
Kurse banorët mbase nuk kishin emër
I merrnin me vete plaçkat e fëmijërisë

Njëherë kur ika nga ëndrra ime
E imagjinuar
Më zunë në gjysmë të rrugës
E dija se çfarë më priste në birucë
Një mi i njohur dhe kova e urinimit
Pandërprerë më përqeshnin

NJË HIJE VDEKJEPRURËSE

Frynte era
Nga gjoksi i murit dilni shtëllunga tymi
Flaka lëpinte ajrin e tendosur
Një hije vdekjeprurëse trokite në dritare

Mbi qiellin e zi fluturonin krahët prej
Duralumini
Shiu i marsit qante si kalama
Një tren veshur me këmishë të bardhë
Vraponte nëpër çmendinë e binarëve

Më kujtohet ishte mesnata
E errët
Në afërsi të një kavaku të thyer
Në prehër të një nuseje
Qante një kërthi
Fërshëllima e trenit
Ia frikësonte vajin e vogëlushit

Atë natë nuk qante asnjë njeri
Treni i ngarkuar me njerëz
Ecte kah luadhi i vdekjes
Në fund të rrugës na prite shiu i zi
Dielli nga palca nxori frikën
Dhe si kali i paçjerrë vraponte lëndinave

KËNDOJMË SI TURTUJT

Nuk di kemi ose nuk kemi kohë
Kur na mundon etja
Këndojmë si turtujt
Flemë mbi kujtimet tona
Vetëm uria na zgjon kur e humbim busullën

Ka raste që i ngjajmë zogjve shtegtarë
Kur dalim nga lëkura e jonë
Bëhemi oazë që shuan zjarrin e mallit
Sytë e erës përngjajnë me lisin
Që nuk i duron zogjtë e pikëllimit

Një ditë bëhemi erë prej bryme
Kurse ditën tjetër
Nuk e njohim vetveten në xhepat e mollëve
Për të mos i thyer dhëmbët artificial
Kafshojmë trungun e kalbur

Të nesërmen i lajmë sytë me lotin e erës
Dhe i terim këmishët e lara në shtrojerë
Pastaj bëhemi se jemi përmendore
Kënaqemi me aromën e luleve plastike
Dhe qeshim deri në çmendi
Me etjen e gurit të murrmë

S'NA NJOHIN AS KARKALECAT

Një ditë kur na dërmon ecja
Do pyesim veten
Ku ishim
Çfarë bëmë në udhëtimin e fundit

Duart tona do i përngjajnë hijes
Do ecin si turtujt para nesh
Kurse ne do mbesim aty ku na lënë
T'i ujisim lulet e një shprese të vrarë

Kalojmë rrugicave të lagjes
Nuk guxojmë të trokasim në asnjë portë
Ku të trokasim
Kur s'na njohin as qepenat e dyqaneve
Zejtarët e moçëm
Mbrëmë e kishin humbur kujtesën

Mëhalla ku u lindëm
Nuk na i njeh këpucët tona
S'na njohin as karkalecat
Sot po përngjajmë me zërat e bretkosave
Dhe me shijen e ujit të mykur

Prishtinë, 5 gusht 2014

KJO HESHTJE PARA TUFANIT

Midis gjërave të pavlera
Shtrihet hija ime e dërmuar
Si mendja e të çmendurit
Më ka ikur gjumi
Mëngjeset i pres me sy të hapur

Kam nevojë për bukë
Kurse nga etja më janë tharë buzët
I lëvizi degët e thyera të akacies
Nga rrapi kryeneç
Shkunden gjethet e durimit

Kjo heshtje para tufanit
Po i përngjan ëndrrës sime të fëmijërisë
Duart lëvizin
Me hapa groteske ngadalë
Ngjajë me oktopodin e dehidruar

Njerëzit më shikojnë si gjërat e pavlera
Në tregun e plaçkave
Një shi imcak me pikëza të rrudhura
Bie mbi thinjat e ditës
Që vuan nga një ekstazë e padukshme

ASNJË NJERI NUK NJOH

Shpeshherë përsëris në vetvete
Ndoshta sot më kujtohet fëmijëria
Por jo
I ngjaj një trungu me zgërbonjë
Ku fryjnë erërat e tërë botës

Një ditë bie shiu i harlisur
Kurse ditën tjetër
Vërshojnë lumenjtë e çmendur
Thyen urat mbi brigjet që nuk ekzistojnë
Horizonti duket si një shalqi
As i pjekur e as i verdhë

Shikoj një pemë të pakuptimtë
Pas shpinës sime rrugët e lagjes
Shtrihen si zvarranik
Tej horizontit

Nuk njoh asnjë njeri
As të tjerët s'më njohin
Nuk më kujtohen çatitë e vjetra
Mbase kurrë nuk isha fëmijë
Në këtë qytet të shurdhtë

GJYSHI IM LUFTËTAR I DISA LUFTËRAVE

Këtu dikur ishte shtëpia e jonë
Nuk di a ishte e vogël
Ose e madhe
Sa e tërë kjo botë e fshehtë
Por ishte e jona mbështjellë me dashuri

Në një këndë të odës së burrave
Si një statujë rrinte gjyshi
Pranë tij një thes i dhirtë
Mbushur me legjenda e lashtësi
Sa herë hidhërohej
Rrëfente nga një histori të trishtë

Ai njeri përngjante kalasë
Që lëviz ngadalë
Historitë njëmijë vjeçare i rruante në kujtesë
I kujtohej koha e thikave
Dhe e hanxharëve të topitur
Gjyshi im ndjesë pastë ishte si bibla e kurani

Një histori e gjallë e cila lëvizte ngadalë
Lëvizte si një dinozaurë
Por i saktë
Në njohjen e njerëzve dhe të kohës
Gjyshi im luftëtar i disa luftërave

JETA KËTU QENKA NDALUR

Trokas në mendjen time
I hapi dyert
Brenda në dhomë fle një dimër i acartë
Si në ëndrrën e fëmijërisë
Fundosem mes këtyre mureve të çara

Dritaret përngjajnë stalaktiteve
Jeta këtu qenka ndalur
As ora e murit të vjetër nuk punon
Një heshtje e tmerrshme i shtrin krahët
Përqafon mysafirin e posa ardhur

Nga dimri dola në dimër hyra
Kallkanët i gjeta të përgjumur
Ftohti i acartë lëpinë lëkurën e erës
S'paska njeri këtu
Që t'i mbyllë dritaret
Koha e egër e akullnajave
Akoma s'qenka shkrirë nën këtë çati

AJO E PRET DIKË

Ishte tepër vonë
Pasi që i mbylle dyert
Përpive çelësin
Harresa u bë ashti yt
Ike diku larg prej vetvetes

Ndoshta të kujtohet
Ishte muaji kur çelnin lulet
Kurse ty të ndiqnin kallkanët
Një borë e verdhë e kristaltë
Të reshte në mendje
Më vonë
U shndërrove në statuja prej harrese

Në të pritëm ashtu siç di vetëm pritja
Me të pritë
Mbase ishte çdo gjë e kot
Nëpër skutat e mykura të metropoleve
Ti ishe bërë harresë

Te portat e hapura që kurrë s'u mbyllën
Një grua e kërrusur
Rri ulur në pragun e kalbur
Ajo e pret dikë
Pret një hije që kurrë s'do të kaloj

LUMIN QË E NJOHA NJËHERË MOTI

Lumin që e njoha njëherë moti
Nuk është më
Po ai i njëjti lumë
Dikur këndonin valët serenatat me të bukura
Kurse sot
Nën parmakët e thyera të urës
Kalojnë grumbuj myshqesh
Të ngarkuara me qeska najloni

Me dallgët që bisedoja dikur
Si me pleqtë e mençur të lagjes
Sot s'mund të flas asnjë fjalë
Edhe ato heshtin
I përngjajnë gurëve të murrmë
Ngarkuar me trishtimin e derteve të ditës

Me lumin që bisedoja dikur në fëmijëri
Nuk paska mbetur asgjë nga ajo kohë
Vetëm nostalgjia
Si një vegim i lashtë
E i tejdukshëm
Më bënë hije në kujtesën time
Dhe më fton
Që së bashku të udhëtojmë në moskthim

NË PREHRIN E PEMËVE

Këtu ishte dikur një kopsht i vogël
Por i madh dhe i pakapshëm
Për ëndrrat tona
I fshihnim në shpirtin e tij
Të gjitha shejtanllëqet e ditës

Ishte edhe një lulebore e bukur
Që rritej
Në prehrin e pemëve
Po kush nuk ngarendte me marr erë
Asaj arome
Që buronte nga shpirti rebel i drurit

Ishte një kopsht prej ëndrrave
Me një vashë syjeshile
E cila në çdo kohë i krihte flokët e erës
Dhe qeshte me ne
Ashti siç dinte me qesh vetëm dashuria

Ishte dikur e diku
Një kopsht tejet i vogël
Që shtrihej nëpër ëndrrat tona të virgjëra
Kopshti me lulet më të bukura
Që rriteshin si tallaz deti
Në ëndrrat tona rinore

MBRËMË E TËRË LAGJA PËRKUNDTE

Një hije e zbehtë si dyshimi
Ecën ngadalë
Përpara një njeriu të humbur
Ai i zgjatë duart
I prek gjymtyrët e thyera të kujtesës

Njeri si hije e mykur zvarritet
Nëpër asfaltin e djersitur
Një zog i vetmuar lahet nën pikat e shiut
Mjegullat e plumbta
Flenë mbi gjethe pemësh të egra

Mbrëmë e tërë lagja përkundte
Djepin e baladave
Një qen i vetmuar
Hungëronte gjatë tërë natës
Hungëronin edhe yjet hapësirave të paanë

Një njeri i humbur në xhepat e veta
I Kërkonte speciet e një tjetër njeriu
Era frynte luginës së ujqërve
Frynte
Si ofshama e një të sëmuri psikik

Mbetëm si tingujt e metaforës
Cikli i dytë

KUR PUSHOJNË TË TJERËT

Nëpër rrugicat e ngushta të qytetit
Kalojnë miza ndriçuese
Dhe karkaleca që kurrë s’pushojnë
Së kënduari

Këtu njerëzit janë të çuditshëm
Heshtin kur nuk duhet
Dhe bëjnë shumë zhurmë
Kur duhet të heshtin

Kanë sjellje anormale
Ngjajnë me këndesat e dehur
Sa herë që u jepet rasti
Me orë të tëra nuk zbresin nga plehu

Kur pushojnë të tjerët
Ata zgjohen dhe si somnambulët
I bien pashë më pashë qytetit
Dhe s’ndalen derisa fundosen në ëndërr

KUR UNË BËHEM HARRESË

Kur unë bëhem harresë
Nëse ajo ekziston
Ju mos harroni asnjëherë
Se ashti i juaj mund të ngjitet me strallin

Unë besoj ashtu siç kam besuar përherë
Se ekzistenca nuk është çamçakëz
E di jam i bindur
Se ju kurrë s'do ta pranoni harresën

Ashti i juaj për t'u forcuar
Duhet të kalitet me zjarrin
Sepse ka lindur nga një copë zjarri
Të zbritur nga shpirtrat e gjyshërve pagan

Ju mos u hutoni
Unë kam mbirë nga kujtesa
Që një ditë të mos bëhem harresë
Nga ashti i saj mua më lindi nëna

HERË I PËRNGJAJMË NJERIUT

Të lutem më kupto ti nuk je manushaqe
Por as unë nuk jam ferrë
Që të dy jemi një amalgamë
E përzier mes gjakut dhe ashtit të ngjitur

Herë i përngjajmë njeriut
E herë s'i përngjajmë asgjëje
Nëpër damarët na rrjedh një lloj lëngu
Që ka një përzierje asnjanëse

Ndonjëherë ngjajmë me njeriun
Kurse në disa raste
As vet nuk dimë se çfarë reaksioni
Po ndodh me shpirtin tonë të trazuar

Të lutem pra nëse nuk duash
Të më kuptosh
Kuptoje bar vetveten tënde
Se ne të dy jemi një përzierje asnjanëse

ÇDO STINË MË DUKET LAKURIQE

Më kuptoni miqtë e mi
Revoltohem vend e pavend
Kur duhet
Dhe kur nuk duhet
E thyej pasqyrën në mur

Në disa raste
Paraqitem se i përngjaj vetvetes
Por menjëherë çmendem
Kur nga brendia ime dëgjohen
Britmat Migjeniane

Jam ose nuk jam unë
Vetvetja ime
Kush mund të jem në këto çaste
Kur për çdo imtësi dal nga lëkura
Më lëndojnë këpucët e shqyera të pemëve

Çdo stinë më duket lakuriqe
Pa brekë si të varfrit
Vetëm një zë nuk më largohet nga koka
Ai zë që i ngjante piskamave të Migjenit
Kur protestonte ndaj urisë

PO E HIDHËROVE TOKËN

Kjo tokë e çmendur e Ballkanit
Ka ngrënë kofsha njerëzish
Të brendshmet e shpirtit
Dhe sy të kaltër të vashave

Ka ngrënë edhe vetveten
Dhe akoma ndjenë uri
Ndaj gjakut
Fle si kuçedra me gojë të hapur

Ballkan i thonë këtu
O vëlla
Po s'pate fat do fundosesh
Në ingranazhet e trishtimit

Këtu të han uji
Të bluan guri si vetveten
Nëse i shkelë hijet e liga
Të shitojnë zanat e malit

Ballkan i thonë këtu
O vëlla
Po e hidhërove tokën
Të kafshon sa çelë e mbyll sytë

NËSE NGJAN E KUNDËRTA

Për të hyrë në shpirtin e lumit
Duhet pritur
Të mos qohet peshë grafullimi
Se për ndryshe të piu e zeza

Trokit në portat e hapura
Sepse ato të mbyllua kurrë nuk çilen
Po që se vonohesh
Era i mbyllë të gjitha dritaret

Kur zgjohesh herët në mëngjes
As ti e as kafeja mos grafulloni
Nëse ngjan e kundërta
Dita do ju shkojë ters

Prishtinë, 6 gusht 2014

MBETËM SI TINGUJTË E METAFORËS

Nëpër të çarat e mureve
Me vështirësi lexohen mbishkrimet
Këtu jetonte dikur dikush
Që kurrë nuk pati emër
Mbiemri i tij
Mbeti relikte nëpër hieroglifët e kohës

Asnjëherë nuk mësuam për prejardhjen
E fjalës asnjanëse
Mbetëm si tingujt e metaforës
E cila ditën e tretë pas lindjes
U shurdhua nga ethet e vjeshtës

Më duket se fajin e kishin eposet
Në shpirtin e Odisesë
Homeri i nguliti peripecitë e Iliadave
Të të gjitha kohërave
Ku vetëm detet çmalleshin me nostalgjinë

Një sirenë e dashuruar në këngën e saj
Dymijë vjet këndoi mbi një kep
Dhe po aq vite
I krehu flokët e dallgëve
Mbase çdo tentim ishte i kot
Fanari përherë i kyçte dhe i shkyçte dritat

KJO RRUGË E GJATË

Në filxhanin tënd të kafesë
Vizatohet një rrugë e gjatë
Sipas të gjitha parashikimeve
Udhëtimi yt është i pashmangshëm

Diku në rrugë do takohesh me një gjarpër
Por mos u frikëso
Është gjarpri i shtëpisë
Që fle në ëndrrat e Iliadave

Më tutje të presin befasitë e panumërta
Kjo rrugë e gjatë
E cila s'përfundon asnjëherë
Rri e përgjumur në sytë e kaltër të erës

TË VEGJLIT JANË KARDINALË

Nuk di se çfarë njeriu jam
Por kurrë nuk më kanë pëlqyer
Lavdit e perëndive

Përherë i kam dashur të vegjlit
Nga shpirtin e tyre i virgjër
Buron një gjelbërim i dendur

Ata kur janë të kamur
Edhe të varfër
I njohin vetëm misteret e këngës

Të vegjlit janë kardinalë
Gjeneralë me pesë yje
Mbretër që nuk iu mungon lumturia

DHE I LËPIN XHEPAT E KËPUCËVE

Me kë të bisedoj në këtë kopsht
Pemët nuk kanë gjuhë
Si të flas me erën
Kur asnjëherë nuk e mësove gjuhën e Eolit

Një kërmill i verdhë
Që shumë pak dallohet nga zverdhimi i barit
I kafshon këpucët e mia të shqyera
Kafshon biografin e udhëtimeve të erës

Këtu nuk më njohin njerëzit as drurët
Po ashtu edhe në qytet nuk më njeh askush
Vetëm kërmilli i përjargur vjen pas meje
Dhe i lëpin xhepat e këpucëve

Nëpër trotuare duar lypsarësh
Shtrihen si hijet morbide në imagjinatë
As këta njerëz nuk më njohin
Mbase e dinë se s'kam çfarë tu japi

KËTU GJENEZA E PËRSËRIT TRAJTËN E SAJ

Pemët e këtij kopshti
Po i përngjajnë trajtës së duarve të erës
Nën hijen e tyre puthen mushkonjat
Një zog i bardhë i mëkon degët

Me qindra lloje trajtash prej njeriu
Mbinë nga rrënjët e drurëve
Turtujt asnjëherë nuk pinë ujë
Nga shpirtrat e gjetheve të fishkura

Një këndes për çdo mëngjes
E zgjon gjelbërimin
Kur bien gjethet këtu njerëzit dashurohen
Dhe i lëshojnë lastarët në drejtim të ëndrrave

Në çdo kohë edhe në mote të liga
këtu gjeneza e përsërit trajtën e saj
Herë ngjan me njeriun
E herë me degët që e përqafojnë hapësirën

M'I PËRKUJTON DUART E TUA

Cilën do qoftë degë që e preki sonte
M'i përkujton duart e tua
Që lëvizin ngadalë
Si një dinozaur
Në trupin tim të rrudhur

Edhe kjo mizë e bezdisshme
Që është duke i shkelur pamëshirshëm
Flokët e mi të qullura
Po ikën nga një ëndërr e trishtë
E natës së kaluar

Fluturimet e zogjve nëpër çati
Sonte po më duken
Si fluturime avionësh të shurdhër
Ngarkuar me ëndrra vdekjeprurës
Fluturojnë
E s'ndalen në asnjë lima mjegullash

Çdo lëvizje e jote mbi çarçafin e verdhë
Po m'i përkujton
Asociacionet e rinisë
Kur për një fjalë goje
I shaloja mjegullat e çmendura të natës

Cilën do qoftë degë të njomë
Apo lastar
Po e preka sonte
Do shndërrohet në kujtesë reliktesh
Vetëm duart e tua të mishta
E kanë aromën e paharruar të pranverës

NJË DITË I ÇELIN PORTAT E JETËS

Thonë se fjalët
Ngjajnë me lulet e kaltra
Çdo ditë çelin në shuplakat e stinës
Çelin dhe shpërndajnë
Një aromë të dëlirë
Nëpër shtatë kodrat e Olimpit

Thonë se perëndive nuk u pëlqejnë
Aromat e luleve të fishkura
Ata jetojnë një tjetër jetë
Që nuk ngjan
Me asnjë jetë tjetër
Ajo është fluide si ekzistenca

Fjalët dhe lulet përherë
Mbinë nga i njëjti trung
Herë u përngjajnë plumbave
E herë thikave të padukshme
Një ditë i çelin portat e jetës
Kurse ditën tjetër i mbyllin në heshtje
Petalet e kujtesës

T'I PREKI YJET KAH ÇELIN ZOGJ

Sonte dua të eci vetëm
Nëpër qiellin me shi
T'i preki yjet kah çelin zogj
Dhe të dashurohem
Marrëzisht të dashurohem
Në shpirtin e meteorëve endacakët

Dua të kem një ëndërr të bardhë
Dhe një zarf të kaltër
Si qielli
E të shkruaj letra dashurie
Njerëzve të vetmuar
Që kanë harruar të dashurojnë

Dua që sonte
Të mos më mungoj asgjë
Të fle
Mbi flokët e tua të mëndafshta
Ta mbështes kokën time kryeneçe
Në muret e bardha
Të gjoksit tënd i cili mugullon dashuri
Që kjo natë
Të jetë vetëm e imja

Ju thashë
Se sonte dua të eci i vetmuar
Vetëm nëpër këtë qiell me shi
T'i shoh njerëzit
Kah janë duke ngarendur
Pas ëndrrave të tyre të brishta
Të cilat çelin
Vetëm dashuri njerëzore

NËN GJUHË I FSHEHIN GJETHET

Pemët e egra dhe të buta në këtë kopsht
Ngjajnë me njerëzit
Çohen herët në mëngjes
Dhe pa i larë sytë
Fill ia nisin punës
Nuk kanë kohë as të vdesin

Ecin vertikalisht nëpër jetë
Kur nga degët i shkundin gjethet
Na bëjnë me dije
Se vjeshta në Ballkan
Nuk është larg

Në disa raste të rralla
Ngjajnë edhe me këndesat
Këndojnë herët në mëngjes
I zgjojnë
Të gjitha speciet e gjalla
Për t'i mos i zënë acari i dimrit

Pemët këtu janë tepër të kujdesshme
Lëvizin ngadalë
Pa u ngutur
Nën gjuhë i fshehin gjethet
Për t'i ushqyer lastarët e së nesërmes

SHIU I MYKTË PO I KALB DRURËT

Në të çarat e drurit i fus gishtat
Ngrohi shpirtin e acarit
Zëri i dimrit të egër
Përngjan me zërin e një bishe të plagosur

Jashtë fushëveprimit të mendjes
S'ndalen ulërimat
Krakëllimat e zogjve mbi sterrën e qiellit
Kurrsesi nuk mejnë në këto çaste

Shiu i myktë po i kalb drurët
Nga zëri i dheut si një piskamë deti
Dëgjohen zërat e gjyshërve
Sa që tremben meteorët endacak

Sivjet pat shumë vërshime në tokën tonë
Vërshuan edhe trungjet e kalbura
Dhe të shëndosha
Nuk dihet se çka na pret pas ikjes së stinës

PAS ATYRE MUREVE TË PLASARITURA

Sonte dallgët nuk pushojnë
Era e çmendur përplaset dritareve
Fanari rri strukur në gjumin e rërës
Dhe i përgjon lehjet e stuhisë

Pas atyre mureve të plasaritura
Në shpirtin e një guaske
Këndon si asnjëherë më parë
Deti i verbër i Homerit

Nën një çati të rrënuar
Nuk ndalen as mjaullimat e maceve
Një varkë e përgjumur
I përkund në thellësi ëndrrat e saja

Sërish nuk pushojnë të reshurat
Ky shi i kaltër që po bie sonte
Mbase po shtrydhet me dhunë
Nga shpirtrat e lënduara të mjegullave

NËPËR RRUGË VËRSHUAN RRUGËT

Sivjet i tërë dimri ishte pranverë
Nuk u ankuan as pemët
Që posa i mbollëm
Nga rrënjët e luleve era shtrydhi pikëllimin

Pritëm edhe dy stinë të tjera
Nëpër rrugë vërshuan rrugët
Kambana dhe ezani
Asnjëherë nuk pushuan sivjet

Pak më vonë erdhi një tjetër kohë
Nëpër shëtitore vrapuan të reshurat
Një nga një filluan njerëzit
T'i stivojnë ëndrrat për dimrat që na presin

ETJA

Jam i etur
Dua të jetoj duke pirë ujë
Asnjë gllënjkë nuk pikon
Nga çatia e rrënuar e kujtesës

Ju erdhët e shuat etjen
Dhe u larguat pa zë
Çfarë i mbeti mbretëreshës
Pasi që u verbuan kuajt

Një zë i lashtë
Shtrydhi tërë pezmin e gjetheve
Deri në mëngjes protestuan rrënjët
Me lotin e vesës era i lagi buzët e thara

Prishtinë, 7 gusht 2014

I THËRRAS TË RESHURAT E VJESHTËS

Veshin e djathtë ia afrova tokës
Kudo rrapëllojnë hapat e tu
Ajo muzikë e mistershme e ecjes
M'i shpon shqisat e të dëgjuarit

Gjethet lëvizin ngadalë
Çmendurisht ngadalë lëviz celuloidi
Në dorën e zgjatur të tokës
Aparati fotografik i shkrep dritat e shkyçura

Ti askund nuk je
Por dëgjohen hapat e tu si ato të erës
Trokasin në mendjen time
Trokasin deri në alivanosjen e barit

Qëndroj mbi një gur të murrmë
Kokën dhe veshin mbështes në ajrin
E turbullt
Asgjë s'dëgjohet në këto çaste
Përpos ecjes tënde nëpër gjakun tim të dehur

I thërras të reshurat e vjeshtës
Mistershëm më afrohen hapat e tu
Pemët stepen si drurët e shkretëtirës
Rëra nën këmbët e mia lëviz si dinozaur

NJËRI ANDEJ HARRESËS E TJETRI KËNDEJ KUJTESËS

Nuk di vallë
Athua unë dëgjova zërin e arsyes
Ose ti e dëgjove zërin tim në mua
Si në ëndrrën e vjeshtës
Lëvizin ngadalë mështeknat

Unë sot nuk di
Se cila është kjo stinë
Që fshihet në xhepat e erës
Është dimri i acartë
Ose po qan pranvera e hershme

Mbase nuk është asnjëra
Jemi mes dy stinëve asnjanëse
Unë këndej kujtesës i thyer përfundimisht
Kurse ti
Andej harresës lëviz kah ikja

Ku janë duart dhe ëndrrat tona
Kur i kapnim zogjtë në fluturim
E sot
Kemi mbetur diku në askundësi
Njëri andej harresës e tjetri këndej kujtesës

BURON PASIONI I PASHËRUAR I IKJES

Për çdo ditë po kthehem nga pak
Në ëndrrën time të largët
Kurse ti largohesh
Po aq nga pak nga unë
Sa që kurrsesi të na puqen rrugët

Unë nisem diku nga lindja
E silueta e jote
U bënë hije qiparisave
Në perëndimin e largët
Edhe më larg largohet një hijet

Ku do ta gjejmë pikëtakimin tonë
Mua nuk më ka mbetur më
Asnjë fjalë e gjallë
Kurse te ty
Si llava e çmendur e shpirtit
Buron pasioni i pashëruar i ikjes

PËR ÇDO DITË

Për çdo ditë
Në kopshtin e imagjinatës
I fiksoj sytë në një dru të njomë
Era m'i ledhaton shqisat e të nuhaturit

Për çdo ditë
Flas me gjethet e fishkura
Vjeshta sivjet zbriti më herët
I shkundi të gjitha frytet e ditëve

Për çdo ditë
Acari ia lëpinë sytë e stinës
Drurët në dimër verbohen pa masë
Pranvera rri larg këtyre shereve të natyrës

DO SHFLETOJMË SONTE HISTORINË

Ky mal qenka më i vogël
Se çdo libër i hapur
Kajsishtat po shkunden sivjet
Po shkunden nga trishtimet e mjegullave

Vonë e kuptuam pasionin e stinës
Ajo i kafshonte mollët e papjekura
Shiun e largonte tej çdo horizonti
U përngjante mbretërve në abdikim

Priste diku në ndonjë skutë harrese
Si bisha e priste prenë e vetë
Por dimri ishte i kujdesshëm
Ngjante me dhelprën e regjur
Kur shkelte mbi akull

Ky mal qenka rritur tej mase
Për librin e madh të jetës
Do shfletojmë sonte historinë
Nëpër buzët e tua të virgjëra

ANIJA

I hapa dritaret e pasqyrës
Dhe i vështrova sytë e tallazeve
Andej detit të pikëllimit
Shtrihej një det i çmendur nga dhembja

Mbi një kep të vetmuar
Dëgjoj vajin e meduzës
Qante edhe shkuma e kripur
Një varkë e vetmuar llamburit nëpër sterrë

Sot herët në mëngjes
Ikën peshkatarët
Gratë e detarëve të Jonit
Me vite të tëra po i lypin anijet e humbura

Një copë dallge në thellësi
I ka hapur velat
Çfarë rruge të gjatë në këtë natë
Do kaloj anija që llamburit në heshtje

I VETËM SI NJË KALLI NË FUSHË

Kaluan më se dymijë vjet
Që s'u pamë
Ku ishe ti gjer më tani
Ike edhe nga ëndrrat e mia
Të kërkova nëpër sytë e grave më të bukura
Dhe s'të gjeta
As në shpirtrat e fantazmave

Akoma sot jetoj me kërkimet
E së kaluarës
I vetëm si një kalli në fushë
Ose kërcu në shtrojerë
Po e numëroj frymëmarrjen e fundit
Të kësaj mështekne
Dhe të pleqërisë

Më duket se
As vetë nuk di se ku je
Rri strukur pas një ëndrre të trishtë
Po ashtu si unë edhe ti i numëron
Çastet e tua të lënduara
I numëron gabimet
Që kurrë nuk ja falëm njëri - tjetrit

NË SHPIRTIN E MEJHANES SË PIKËLLIMIT

Athua ishe ti ajo
E cila mbrëmë
Si trishtimin
E zbrazi me fund
Gotën e pikëllimit

Mbi degët e thyera të mështeknës
Si era e tërbuar
Me ngashërim
Qante edhe nata e vetmuar
S'pushonin as gjethet e fishkura

Një lot i hidhur
Dëneste me lotin tjetër
Kupa e mbushur
E dhembjes
Dehej si trishtimi i lindur

Njerëzit ecin me kokëfortësinë e tyre
Rrugët zgjaten tërkuzë
E gotat zbrazen
E zbrazen
Në shpirtin e mejhanes së pikëllimit

SHIKIMET E TUA TË LARGËTA

Vetëm sa një cipë e hollë e ajrit
Je larg meje
Të kam afër si frymëmarrjen time
I preki me sy
Shikimet e tua të largëta

Për çdo mëngjes
Kur zgjohet këndesi i parë
Unë i ujis lulet e mbjella në kujtesë
Dhe me duart e erës
I shpupuris flokët e tua të mëndafshta

Ti s'bëzan
E qetë si statuja e Afërditës
Në maje të një peme
E kërkon pikën e azimutit
Kurse qepallat e tua
Turpshëm shikojnë kah toka

ISHTE DIKUR

Ishte dikur
Diku
Një mëngjes i hershëm
Askush pranë meje
Vetëm gishtat e tu si qirinj ndriçonin
Hapësirën që më ngufate pamëshirshëm

Ishim edhe ne dikur
Diku
Në një vend të papërcaktuar
Askush pranë nesh
Vetëm duart tona të mishta
Përqafonin hapësirën që vdiste nga dashuria

Shoh se si përpëliten eshtrat
Cikli i tretë

NUK DO TË ISHTE NJË TËRËSI

Vetmia është e zbrazët pa mendime
Asgjë nuk gjendet në brendinë e saj
Posa i çelë sytë
Ajo vdes nga trishtimi

Po ashtu vdesin edhe gjërat
Që vuajnë nga kjo sëmundje
Ato gjëra të imta të pavlerë
Zhduken si flluska sapuni në ajër

Thash se vetmia është e zbrazët
Nuk ka mendje as rropulli
S'i përngjan asgjëje
Andaj edhe është vetëm një copë pa formë

Unë nuk shoh asgjë të vetëm
Çdo krijesë në jetë e ka pjesën e saj
Pa të cilën
Nuk do të ishte një tërësi

NË QYTETIN TIM

Në qytetin tim
I dëgjoj zërat e mbrëmjeve
Shpupuris nëpër udhët e së kaluarës
Dhe sërish dukem si një fantazmë
E humbur në shpirtin e erës
Nga ëndrra e së cilës
Fëmijët zgjohen të përgjumur

Në qytetin tim
Paska edhe gra të bukura
Këtu mermeri i skalitur shkrihet
Në lotin e brishtë të Lumëbardhit
Kurse nën Urën e Gurit në heshtje
Si përherë rrëshqasin shekujt

Në qytetin tim
Ende ka zjarre të mëdha që s'shuhen
Ka edhe varre të panjohura
Netëve të vona të vjeshtës
Vetëm njëherë në vjet
Të vdekurit vallëzojnë vallen e vdekjes

PO SHOH EDHE NJË MUSHKONJË

Po shoh një pemë
Që ekziston këtu para njeriut
Me gjymtyrët të rrudhosura
Merr frymë si një lule mishngrënëse

Po shoh edhe një njeri
Ulur mbi gurin e kujtesës
Nga mendja e të cilit çurgon rrëshira
Për shërimin e insekteve

Po shoh edhe një mushkonjë
Që rri mendueshëm mbi kallamin e thekrës
Ditës këtu i duhen njëmijë shekuj
Derisa të mbërrij shkëlqimin e perëndimit

QË NUK KANË ASNJË ITINERAR

Ecin njerëzit ecin duke u fshehur
Nëpër mjegulla shpirtrash
Secili prej tyre
Mbanë nga në dhimbje në kujtesë

Ecin e nuk ndalen as milingonat
Ngarendin prej një ane
Në anën tjetër të ekzistencës
Lëvizin sipas një shpejtësie lakore

Njerëzit duken sikurse fshihen
Pas një tregimi që nuk ekziston
Nëpër bibliotekat e vjetra
Shkundin pluhurin e së kaluarës

Ecin e nuk ndalen në asnjë stacion
Përngjajnë me trenat
Që nuk njohin itinerar
Ecin pa qëllim
Grumbuj njerëzish dhe milingonash

NË KËTË QYTET TË VRARË ME SHEKUJ

Në dhomën time të boshatisur
Fle zbrazëtia
Sipas një ligji të lashtë
Jashtë rrotullohen gjërat dhe mjegullat
Kuajt e luftës i shalojnë plagët

Prej një këndi të rrugës ku flenë këndesat
Dëgjohet zëri i shurdhët
I kambanës së vjetër
Mbi degët e një qiparisi të moçëm
Flenë pëllumbat e plagosur të luftës

Në qytetin tim çdo gjë duket e vrarë
Po ashtu
Janë të vrara edhe shpirtrat
Te varret e vjetra të luftëtarëve
Hijet e zeza i përdhosin përmendoret

Këtu në të shumtën e rasteve
I lidhim me fasha
Plagët e pashërueshme të drurëve të moçëm
Në këtë qytet të vrarë me shekuj
Asnjëherë deri më tani nuk u shëruan plagët

GURTË E LAGJES DËNESIN ME NGASHËRIM

Që të dy njëkohësisht shikojnë
Njëri - tjetrin
Shikojnë dhe shohin në sytë e secilit
Nga një copë atdheu të vjedhur

Një copë toke të grabitur
Dhe pak nostalgji
Për varret e dhunuara
Mbi degët e mollës
Era e plagosur qan me lot të plumbtë
Qajnë edhe kujtimet e hidhura

Në kolona të gjata njerëzish
Ecin në moskthim
Ecin si statuja të bardha nëpër sterrë
Pranë rrugëve të kalldrëmta
Shemben kolonadat
Një nga një shemben perëndit

Nënat me sy të përlotur
I shërojnë
Plagët e pashërueshme të atdheut
Qajnë edhe drurët
Gurtë e lagjes dënesin me ngashërim

LËVIZIN EDHE MURET

Nuk di dhe nuk njoh asnjë shkak
Përse i lëvizi gurtë
Por për çdo mëngjes
Lëvizi nga një copë
Gur të murrmë tërmal plagëve

Këtë punë
Nuk e bëj për asnjë fitim material
As nga dëshpërimi
Por rrotullimi i gurëve
Më ka mbetur si një peng nga lashtësia

Ngado që lëvizi
Lëvizin edhe muret
Gurtë e lagjes më përcjellin tinëzisht
Më përcjellin
Si njeriun e shtëpisë
Më shikojnë me një besim të paçmuar

Prishtinë, 8 gusht 2014

KUR ÇMENDESHIN NETËT E ÇMENDURA TË BALLKANIT

Është natë
Era e bezdisshme s'dëgjon zërin tim
Si e çmendur vrapon
Nëpër zgavrat e shqisave të nuhaturit

Megjithatë ndonëse
I kam kapërcyer disa kohë të turbullta
Mendjen e kam të shëndoshë
Bashkëjetoj me poezitë e Migjenit

Kur më duken se po zgjatën netët
Shfletoj ditarin e erës
Rrufis një kafe farmak
Dhe më pastaj pikturoj heshtjen

I zgjas duart kah shpirtrat e vargjeve
Përshëndes atë më të bukurën
Që mbiu nga shpirti i virgjër i Frederikut
Kur çmendeshin netët e çmendura ballkanike

SHOH SE SI PËRPËLITEN ESHTRAT

Sërish dëgjoj dhe i shoh
Zërat dhe ankthet e fëmijërisë
Si diej të përskuqur
Më rrinë mbi kokë fantazmat
Edhe kësaj here nuk kapërcejnë
Pa m'i prekur gishtat e thyer

Dëgjoj dhe shoh si një vegim
Zërin e fëmijërisë
Ankthet më duken
Më groteske se asnjëherë më parë
Pamëshirshëm shkelin
Mbi shpirtin e gjelbërimit të njomë
Shkelin me shputat e zjarrta të trishtimit

Shoh se si përpëliten eshtrat
Mbi çatitë e dhunuara të qytetit
Herë bien e herë ngritën
Deri në kupë të qiellit
Dhe më pastaj

Lëshohen pingul mbi tallazet e gjakut tim
Që brymëzohet
Si acari i ngrirë i vjeshtës
Dhe bie si reja
Mbi pemët e pikëlluara

Nata me gishtat e qirinjtë të hënës
I përzhitë edhe më shumë
Degët e fishkura të degëve të thyera
Kur nëpër lastar e shpirtit
Vdesin në çdo çast shpresat e lënduara

SE JAM ZVOGËLUAR PËR SË TEPËRMI

Kjo dhomë e vogël e ngushtë
Nuk po m'i zë ëndrrat
S'po ka vend as për këpucët e mia
E lëre më për gjëra të tjera

Vetëm për flokët e erës
Dhe zërin e djersitur mund të gjendet
Pak hapësirë për ta mbështetur kokën
Mbi gjoksin e murit të lagshtë

Kjo dhomë e vockël e ngushtë
Që shtrihet në pëllëmbë të dorës
Me xhelozi i fsheh ëndrrat e fëmijërisë
I fsheh edhe dështimet e jetës

Kjo dhomë me librat dhe reliktet e saja
Aq duket e madhe sot
Sa që përfundimisht po më duket mua
Se më janë zvogëluar duart për së tepërmi

KËNDON E GJITHË NATYRA

Çdo mëngjes herët
Kur ty të përkund ëndrra
Unë mbështes kokën time
Mbështes
Në kërthizën tënde lakuriqe
Dhe dëgjoj se si këndon gjeneza

I dëgjoj këngët më të mira
Të zërit të erës
Këndon uji
Nuk ndalen as shushurimat e gjetheve
Këndon e gjithë natyra
Psalmet e pa kënduara të dashurisë

ME KË DO KËNDOJ SONTE

Me sy të acartë më shikon dimri
Duart e humbura nëpër xhepa
Hulumtojnë errësirën
Një zë prej peme
Hungëron si një bishë e plagosur

Shikoj në zbrazëtirën e natës
Hapen dyert e kallkanta
Jashtë dhomës së gjumit
Lehje qensh
Kurse përbrenda mureve të akullta
Ngrihet ajri i tymosur prej nikotine

Më duket se kanë mbetur
Edhe disa hapa
Deri te ëndrra e jote
Si i verbëti shikoj tej mureve
Më dridhen duart dhe koka
Si thupra e çeliktë dridhet i tërë universi

Ngadalë pjalmojnë flokëzat e borës
Bien si meteorët
Nga zëri i erës së shurdhtë burojnë acaret
Dimri i vetmuar i thërret baladat
Me kë do këndoj sonte
Kjo natë e gjatë e zërave të humbura

KJO PËRDITSHMËRI E TURBULLT

Vrapojnë ose kalojnë tej urës
tepër i hutuar
Njerëz të humbur
Drurë të mjegulluar nga mendja
Kapërcejnë lumin si hijet e pikëlluara

Dy njerëz të panjohur me duar të shtrira
Ma vrasin syrin dhe mendjen
Pranë brigjeve dëgjohen shtërzimet e zogjve
Duke çelur në maja të zambakëve

Heshtin përmendoret e mermerta
Heshtin dhe i zgjasin duart e mishta korbat
Tok me shikimet e zbrazëta
I zgjasin derisa të na i verbojnë sytë

Nën urat e drurët
Për çdo ditë mbyten algat e murrme
Kalojnë kalimtarët me syze e pa to
Disa shohin gjëra që s'duhet parë

E disa të tjerë as që e kthejnë kokën
Kjo përditshmëri e turbullt
Po i ngufat për së tepërmi
Rrugët dhe shpresat e myshqeve të verdha

NATA SI NJË ANIJE E VETMUAR

Ai qëndronte mbi një gur të murrmë
Dhe gjithë pezëm
Gjuante zbrazëtirën e paanë
Në thellësi të horizontit
Duket se fanarit i duhej ndihma

Një acarë i ngrirë vjeshte
Ulur mbi pikturën e stinës
I shkundte pemët e pjekura
Nga një mallëngjim i padukshëm
Kajsishtat i fshinin lotët e erës

Po ai njeri rrinte sërish mbi gur
Tani e gjuante sterrën e padukshme
Gjuante diku diçka të pavlefshme
Por gjithsesi
Ai gjuante drejtë zërit të natës

Ishte po ai zë që buronte diku nga brendia
E yjeve endacak
Dhe i grishte në dasmë meteorët
Nata si një anije e vetmuar
Qëndronte fundosur
Në zërin asnjanës të heshtjes

PËR NJERËZIT DHE GJYSHËRIT E MI

Një ditë kur do kthehem
Si një shtegtar
I cili nuk i shpëtoi dot harresës
Do kthehem
Me vetmin dhe bastunin tim
S'do më njoh askush përpos muranave

Për njerëzit dhe gjyshërit e mi
Do i pyes ëndrrat fëmijërisë
Sepse çdoherë ato
Njëherë në njëqind vjet
Përsëriten sërish
Do i pyes varret dhe arkivolet e blerta

E di unë
U besoj pemëve dhe njerëzve
Besoj se do të më tregojnë
Për secilin varr
Dhe arkivol
Që s'deshi të mbulohet me dhe
Pa e lënë peng amanetin e gjyshërve të mi

PEMA E EGËR QANTE TOK ME ERËN

Si gjak lepurushi gulçonte
Një hije e thyer në shtrojerë
Hëna ngjante
Me lakuriqët e verbër
Pema e egër qante tok me erën
Nëpër trungjet e prera të stinës
Trishtueshëm rriteshin trishtimet

Loti lotin nuk e ndalte
Nën urat e drurët
Me ngashërim të padëgjuar qante
Një lumë i çmendur
Këtu me vite të tëra
S'kishin çelur trëndafilat asnjë qeshje

Për çdo ditë këndej pari
Bari i zverdhur
Fishkej në gjoksin e erës

Njerëzit që i përngjanin pemëve
Kishin dalë në rrugë
Dhe mbi çatitë e kujtesës
I përshëndetnin lejlekët e bardhë

Prishtinë,9 gusht 2014

Adem Zaplluzha u lind më 1943 në Prizren, Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990,* nga Hasan Hasani, në *Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995* nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin *Portrete Shkrimtarësh* nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1. **“Puthje”, poezi,** “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “**Ecjet e viteve të mëdha”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. **“Çamarrokët e Thepores”,** poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4. **“Muret”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. **“Morfologjia e dhembjes”,** poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. **“Ai vjen nesër”,** poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. **“Letër nga mërgimi”,** poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. **“Letër nga mërgimi 2 “** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. **“Udhëndarja”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. **“Thirrje e gjakut”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. **“Asgjë sikur molla”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. **“Vesa në lotin tim”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “**Puthja e gozhduar”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. **“Kashelasha në vargje”,** poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.

15. **“Pema e bekuar”,** E përkthyer, Rumani, 2o1o.
16. **“Bajraktarët e vatanit”,** poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. **“Hijet e ndryshkura”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18**.”Stuhi në Kutulishte”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. **“Posa ikte nata”,** poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o**. “Loja e myshqeve”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. **”Lumëbardhi dhe gjëma”,** poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22**. “Metafora e heshtjes”,** poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. **”Hyji në Prekaz”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. **”Sinorët e hinores”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. **”Don Kishoti dhe Rosinanti”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26**.”Zjarri i dashurisë”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. **”Kur likenet vallëzojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28**. “Ditari në vargje”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 201O
29. **“Tingujt që nuk përfundojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o**. “Shtegu i mallit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010

31. **”Korniza e thyer”’**,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010
32. **“Zgjimi i gjëmës”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. **“Vallja mistike”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2010
34. **”Merre kodin”,** Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. **“ Letër atdheut”** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. **“ Tejdukshmëria e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. **“ Përtej teje”**,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. **“Sa afër e sa larg”** , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. **“Vallja e zanoreve”,** Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. **“Ikja e eshtrave”,** Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41**.”Kalorësit e mjegullave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. **“Hingëllimat e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. **“Kur pemët i ndërrojnë këmishët”.** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. **“Mirëmëngjes Imzot”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45**. “Kafshimi i mikut”,** Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. **“Atje tej maleve”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012

47. **“Heshtja që del në shesh,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12
48. **“Portat e shpresës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. **“Në dhomën time gjysmë të errët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. **“Kinse Lojë Shahu”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. **“ Për çdo dekadë nga një baladë “,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. **“Fusha e mëllenjave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. **“E kujt është kjo vetmi”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. **“Mos pyet për adresën e lumit”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55**. “ Stoli në parkun vjetër”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “**Urori i stralltë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57**. “Po të mos ishte fjala”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. **“Thyerja e urave”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59**. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60**. “ Në flokët e dëborës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61**. “Një grusht nostalgji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. **“ Kur filluan të flasin njerëzit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012

63. **“Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012
64. **“ Lisi në rrënjët e veta”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. **“Eca ecëm dhe do ecim”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66**. “Fëmijët e erës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. **“ Çast në fund të stinës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. **“Si të flas me drurët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69**, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70**. ”Andej dhe këndej kohës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71**. “Zëri i heshtjes”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
72**. “Kush i lexoi letrat prej erës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73**. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”,** prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. **“Koha e ime dhe koha e jote”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75**.” Diku te një baladë”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76**. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 **“ Ky def prej hëne”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012

78.**“Pyesni zogjtë në ikje ”,**Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013
79 **“ Fërfërimë gjethesh**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
80**. “Refrene yjesh”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. **“Te delta e mjellmave”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
82.**“Rinjohja”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83**.“Diku në fund të një fillimi”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84**.“Makthi i hijes”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85.**“Një zog prej uji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot,2013
86**.”Asnjë fjalë nuk frymon”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014-
87**.”Daullet e një nate”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot 2014
88**.”Sytë e gurtë të erës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
89**.”Kur dehen perënditë”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
90. **“Fjetëm njëqind shekuj”** Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot ,2014
91**.”Krakëllimat e natës”,**Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
92. **“Ndjekësit e enigmave”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014

93. **“Atdheu i paçmuar**”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
94**.”Psalm i harruar ”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”**Për që po bie moj kambanë**”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
96. **“Mbi flokët e ullukëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. **“Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e** Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98**. “Loti i gotës së dehur”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99**. ” Stina asnjanëse”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. **“Dëneste bashkë me erën”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. **“Druri i pikëlluar**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
102. **“ Një grusht dashuri”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
103. **“Lëreni zërin tim”** , poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
104. **“Shi në qytetin tim”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
105. **. “Si trenat e verbër ” ,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
106. **“Zjarri i malli tim ”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
107 **. “Kur teshtinë era** ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014

108. "Mbi shpirtin e erës pagane " , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
109. "Nëpër gjymtyrët e mjegullave " , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
110"**Ajo nuk erdhi sonte"** Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
111."Një hënë e zhveshur",Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
112. "**Nëpër plasaritjet e mureve",**Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
113."Mes telave gjembor ",Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
114. "Të vizatosh një zog në mur",Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
115." Nuk flenë as kuajt e dehur" Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
116"Fluturojnë zogjtë e verbër " Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
117. "Një shi prej bryme" , Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
118. "Në prehrin e pemëve" , Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015

PËRMBAJTJA

Kur shiu i zgjatë duart
Cikli i parë

Hëna e mekur 17
Ose i lutej erës së verbët 18
Nuk di se ku jam sot 20
Kur shiu i zgjatë duart 21
Lukunitë e zeza të ujqërve 22
Dielli i uritur i përtypte hijet 23
Një nga një po bien perënditë 24
Asnjë zog nuk fluturoi mbrëmë 25
Po bie një shi i përgjumur 26
Nën mustaqet e brigjeve të virgjëra 27
Lehnin edhe zogjtë nga uria 28
Nuk kam kohë për të humbur 29
Herë binte shiu i mrrolur 30
Një hije vdekjeprurëse 31
Këndojmë si turtujt 32
S'na njohin as karkalecat 33
Kjo heshtje para tufanit 34
Asnjë njeri nuk njoh 35
Gjyshi im luftëtarë i disa luftërave 36
Jeta këtu qenka ndalur 37
Ajo e pret dikë 38
Lumin që e njoha dikur moti 39
Në prehrin e pemëve 40
Mbrëmë e tërë lagja përkundte 43

Mbetem si tingujt e metaforës
Cikli i dytë

Kur pushojnë të tjerët 45
Kur unë bëhem harresë 46
Herë i përngjajmë njeriut 47
Çdo stinë më duket lakuriqe 48
Po e hidhërove tokën 49
Nëse ngjan e kundërta 50
Mbetëm si tingujt e metaforës 51
Kjo rrugë e gjatë 52
Të vegjlit janë kardinal 53
Dhe i lëpinë xhepat e këpucëve 54
Këtu gjeneza përsërit trajtën e saj 55
M'i përkujton duart e tua 56
Një ditë çelin portat e jetës 58
T'i preki yjet kah çelin zogj 59
Nën gjuhë i fshehin gjethet 61
Shiu i myktë po i kalb drurët 62
Pas atyre muranave të plasaritura 63
Nëpër rrugë vërshuan rrugët 64
Etja 65
I thërras të reshurat e vjeshtës 66
Njëri andej harresës e tjetri këndej kujtesës 67
Buron pasioni i pashëruar i ikjes 68
Për çdo ditë 69
Do shfletojmë sonte historinë 70
Anija 71
I vetëm si një kalli në fushë 72
Në shpirtin mejhanes së pikëllimit 73
Shikimet e tua të largëta 74
Ishte dikur 75

Shoh se si përpëliten eshtrat
Cikli i tretë

Nuk do të ishte një tërësi 79
Në qytetin tim 80
Po shoh edhe një mushkonjë 81
Që nuk kanë asnjë itinerar 82
Në këtë qytet të vrarë me shekuj 83
Gurtë e lagjes dënesin me ngashërim 84
Lëvizin edhe muret 85
Kur çmendeshin netët e çmendura të Ballkanit 86
Shoh se si përpëliten eshtrat 87
Se jam zvogëluar për së tepërmi 89
Këndon e gjithë natyra 90
Me kë do këndoj sonte 91
Kjo përditshmëri e turbullt 92
Nata si një anije e vetmuar 93
Për njerëzit dhe gjyshërit e mi 94
pema e egër qante tok me erën 95

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Në prehrin e pëmeve : poezi / Adem Zaplluzha. – Prishtinë : Trend, 2015. – 108 f. ; 21 cm.

Parathënie / Sabir Krasniqi : f. 7-14. - [Shënime për autorin] : f. 96-104

ISBN 978-9951-694-07-0